



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:050428

Datë: 19.04.2019

Numri i dokumentit: 00284507

P.nr. 22/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, punëtore e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit J. Z. U. nga fshati N. Komuna e Ferizajit për shkak të vepres penale vetëgjyqësi nga neni 418 par. 2 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzes të PTH në Prizren PP.II.nr. 2488-2/17 të dt. 17.01.2018, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.12.04.2019, në prezencë të PSH Milot Krasniqi, të akuzuarit si dhe të dëmtuarit, muarrë dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 19.04.2019 perpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari J. U., nga i ati Z., i lindur me dt.08.01.1986, nga fsh. N., ka të mbaruar arsimin fillor, i martuar, puntor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 13.07.2017 rreth orës 17,30 minuta në fshatin G. Komuna Suharekë, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kunderligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër ose për të shkaktuar dëm material personit tjetër, mashtron në atë menyrë që derisa i pandehuri ishte duke kryer punime si elektrikist në shtëpinë e të dëmtuarit S. R., nga aty merre 3 (tre) abazhurë në vlerë prej 300 (treqind) euro, kinse për të rregulluar në Ferizaj, e më pas për të kthyer dhe montuar në shtëpinë e të dëmtuarit, por i pandehuri nuk i kthen me ato.

Këso dore ka kryer veprën penale vetëgjyqësi nga neni 418 par. 2 të KP.

Gjykata në kuptim të nenit 41,51,52,73,74, si dhe nenit 418 par. 2 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

DENIMIN ME KUSHT

Të akuzuarit J. U. duke ia vërtetuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej tre muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej një viti, nuk kryen veprë të njejtë apo të ngjajshme penale.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € dhe taksën për kompenzim të viktimave të krimit shumë prej 30 €.

I demtuari S. D. R. nga fshati G., për realizimin e kërkesës pasururo juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH nga Prizreni me akuzën PP.II.nr.2488-2/17 të dt. 17.01.2018, ka akuzuar J. Z. U. nga fshati N. për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KP, aktakuzën të cilën gjatë séancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e saj e ka përfaqësuar PSH Milot Krasniqi, i cili pas administrimit të provave vleron se kjo gjendje faktike e vërtetuar përkon me veprën penale vetëgjyqësia nga neni 418 par. 2 të KP, e jo vepra penale mashtrimi siq është cek në aktakuzë, në tërsi ngel pran të dhënave si në aktakuzë të ricilësuar, i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari në séancë nuk e ka pranuar fajsin, Gjykata administroi me provat ku ka dëgjuar të dëmtuarin në cilësi të dëshmitarit S. R., ka bërë leximin në vërtetimin mbi sekuestrimin e sendit të dt. 1.0.2017, raporti i oficerit të dt. 2.0.2017, vërtetimi mbi kthimin e sendit projekti për instalimin e rrymës fakturën DFE0...../18 dhe shkresat tjera përcjellëse, të cilat gjenden në lëndë si prova materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

I dëmtuari S. R. i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit në séancë ka deklaruar se përmes firmës B. kam kontraktuar ndertimin e shtëpisë, i akuzuari i cili është sternip i imi ka kërkuar nga unë që instalimin e rrymës në shtëpi ta bënte ai, por pasi që ky ka qenë detyrim i B. unë kam kontaktuar me pronarin dhe punën e instalimit të rrymës pronari ia ka besuar të akuzuarit për çmimin kontraktues 300 €, megjithatë ky çmim në nderkohe është rritur edhe dy here nga 50 €. Bashkë me të akuzuarin në një shitore në magjistrale Ferizaj – Prishtinë e kemi blerë të gjithë materialin elektrik, aty kanë qenë edhe 4 llusterë, njëri prej të cilëve ka qenë i montuar në vend, ndërsa tre të paketuara. I akuzuari në shtëpinë time ka instaluar vetëm llusterin i cili ishte i montuar në lokal, ndërsa me arsyetimin se tre llusteret e paketuara duhet të montohen në shitoren ku janë blerë i ka marrë të njejtë nga shtëpia ime dhe i ka dorëzuar në shitore ku ishin blerë me qellim që ty të shlyente borzën që paraprakisht ia kishte ati, këtë faktë e kam vërtetuar nga vetë shitesit i asaj shitore. Të njejtë llusterë i akuzuari nuk i ka vendosur kurrë në shtëpinë time, por të njejtë i ka instaluar dikush tjetër – J. Q., për qka jam detyruar të paguaj dy here. Edhe vetë jetoni me ka thënë se me qëllim të shmangëjes se një procedurë permbarimore tek permbaruesi privat nga pronari i shtëpisë ku është furnizuar ja ka lenë llusteret me qellim të kompenzimit dhe shlyrjes së borzës por me atë rast me ka premtuar se të njejtë do të sjelle me vonë, gjë që nuk e ka bërë kurrë.

Me këto veprime më është shkaktuar dëm material dhe kërkoj të kompenzohem për lartësinë e dëmit nuk mund ta përcaktoj.

I akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar se une jam puntor i kompanis Koorporata Energjetike Elektrike SH.A Ferizaj, dhe jam kordinator i punëve dhe projekteve ne ate ndermarrje e zbatoi vendimet e punëdhënsit. Ka pohuar se ka qenë i obliguar ti kryej punimet në shtepin e të dëmtuarit S. R. në instalimin e rrjetit sipas marrveshjes me firmen “B.”, poashtu ka pohuar se ka pas per obligim edhe furnizimin me material elektrik. Ka qene obligimi i tij edhe instalimi i llusterve (abazhuret) dhe atë ne afat prej 4 ditesh, por të njejtit nuk i kam instaluar pasi qe detyrimi per pagese ka qenë tri ditë, ndersa pagesa nuk është kryer mbrenda ati afati. Ka pohuar gjithashtu se abazhuret i ka marrë nga shtepia e te demtuarit me qellim te rimontimit por gjithashtu ka pohuar se të njejtit nuk janë kthyer dhe montuar ne shtepin e te demtuarit me arsyetimin se nuk janë paguar paraprakisht.

Nga provat e administruara gjykata me pa medyshje ka vërtetuar se me datë 1..0..2017 rreth orës 17,30 minuta në fshtin G. Komuna Suharekë, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të perfitimit të kunderligjshem të dobisë pasurore per vete apo personin tjetër ose per ti shkaktuar dem material personit tjetër, mashtron në atë menyre që derisa i pandehuri ishte duke kryer punime si elektricist në shtepin e të dëmtuarit Sali Reshani, nga aty merre 3 (tre) abazhurë në vlerë prej 300 (treqind) euro, kinse per ti rregulluar në Ferizaj, e më pas per ti kthyer dhe montuar në shtepinë e të dëmtuarit, por i pandehuri nuk i kthen me ato.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga deshmitari - te demtuarit S. R. i cili ka provuar faktin se ditën kritike i akuzuari kishte sjell 4 abazhure në shtëpin e të dëmtuarit dhe po të njëjten ditë ka marre nga shtepia e tij tre abazhure kinse me qëllim të rimontimit por të njejtit nuk i kthen më.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar në tërsi nga vete mbrojtja e te akuzuarit i cili ka pohuar faktin se abazhuret fillimisht i ka derguar ne shtepin e te demtuarit e me pas tre prej tyre i ka marrur perseri për shkak të mos pageses per materialet e furnizimit.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga raporti i oficerit në të cilin është konstatuar se me dt. 1..0..2017, J. ka marrë me vete 3 lluster (abazhure) dhe i ka dorzuar në shitore ku i kishte blerë.

Ketë gjendje faktike e ka vërtetuar edhe nga fatura e mallrave të blera ku sifet se janë blerë 4 abazhure ndërsa nga dëshmitari dhe i akuzuari u vërtetua se vetëm një është montuar në shtëpin e të dëmtuarit.

Nga nje gjendje e tille faktike e vërtetuar gjykata ka ardhur ne perfundim se ne veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të vepres penale vetegjyqësi nga neni 418 par. 2 te KP, pasi që i akuzuari me terheqjen dhe marrjen e abazhureve nga shtepia e te demtuarit pa pelqimin e te demtuarit në emër të borgjit te pa paguar ngerthen ne vete pergjegjës sin penale pasi qe me dashje me vetedije te plotë, ne menyre të kunderligjshme kryen keto veprime ne vend se per borgjin ti drejtohem organeve kompetente ne procedurë ligjore.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi denimin pati parasysh rrethanat nga neni 73 dhe 74 të KP, në rrethanat në të cilat vepra është kryer, shkallen e përgjegjesis penale të kryerjes, vleren e të mirës së mbrojtur dhe demit të shkaktuar. Si rrethan letësuese gjykata mori fakin se i njejt i nuk ka qenë me parë i denuar, është familjar, ndërsa rrethen posaqerisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesen pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 453 të KPP.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 22/18 të dt. 12.04.2019

Sek. Juridike
F. Kabashi

G j y q t a r i
Robert Tunaj

UDHËZIME JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e paranimimit të tij ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe gjykatën.